

VENDIM
Nr. 702, datë 21.8.2013

PËR TRAJTIMIN ME USHQIM TË PUNONJËSVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHETIT, TË STUDENTËVE DHE KURSANTËVE NË SHKOLLA TË POLICISË SË SHETIT, SI DHE TË SHTETASVE TË NDALUAR DERI NË SQARIMIN E POZITËS SË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 127 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të shkronjës “g” të pikës 2 të nenit 39 të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e Gardës së Republikës trajtohen me ushqim, pa pagesë, si më poshtë vijon:
 - a) Me një vakt ushqim, në njësitë speciale, grupet e gatshme të të cilave, për natyrë të veçantë pune, shërbimi u zgjat më shumë se koha normale e punës;
 - b) Me tri vakte, i gjithë efektiv i Gardës së Republikës, për rastet e kalimit në gatishmëri.
 2. Punonjësit e strukturave të veçanta të Policisë së Shtetit, si Forcat Speciale dhe të Ndërhyrjes së Shpejtë, trajtohen me ushqim, pa pagesë, si më poshtë vijon:
 - a) Me një vakt dreke, kur shërbimi i punës është 8 (tetë) orë;
 - b) Me tri vakte, kur janë të angazhuar në veprime operacionale që zgjatin më shumë se koha normale e punës, 8 (tetë) orë.
 3. Të gjithë studentët dhe kursantët në shkollat e policisë dhe në institucione të tjera të Policisë së Shtetit, brenda vendit, trajtohen me tri vakte ushqim pa pagesë.
 4. Trajtohen me tri vakte ushqim pa pagesë edhe kategoritë e mëposhtme:
 - a) Shtetasit e huaj, që hyjnë ilegalisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, deri në sqarimin e pozitës së tyre;
 - b) Shtetasit shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera, deri në sqarimin e pozitës së tyre;
 - c) Shtetasit e ndaluar ose të arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre ose deri në transferimin e tyre në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP).
 5. Normat e ushqimit ditor për të gjitha strukturat përfituese të këtij shërbimi, të përmendura në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të propozuar nga Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Shëndetësisë, ku përcaktohen:
 - a) normat e artikujve ushqimorë, brenda limitit të miratuar të k/kalorive, duke ruajtur raportin e njësive ushqimore;
 - b) normat e pajisjeve dhe të materialeve të shërbimit të ushqimit.
 6. Shërbimi i ushqimit të bëhet me ushqimin e gatuar në mensa, si dhe me shërbimin katering, i cili duhet t’u nënshtrohet të gjitha procedurave të prokurimit, ashtu si çdo shërbim tjetër që financohet nga fondet publike.
 7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme.
 8. Vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 494, datë 1.8.2007 “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, të studentëve dhe të kursantëve në shkollat e policisë dhe të shtetasve të ndaluar, deri në sqarimin e pozitës së tyre”, dhe nr. 573, datë 14.7.2010 “Për trajtimin me ushqim pa pagesë të efektivave të Gardës së Republikës”, shfuqizohen.
 9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe për punonjësit e Gardës së Republikës i shtrin efektet e zbatimit nga data 1 janar 2014

KRYEMINISTRI
Sali Berisha